



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

Nr. 790 Prot

Tiranë më, 05/05/2015

PROGRAMI I TRANSPARENCËS
PËR
Agjencinë Kombëtare të Mjedisit

I. HYRJE

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përgatitur programi i transparencës për Agjencinë Kombëtare të Mjedisit. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”(LDI).

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Agjencia Kombëtare e Mjedisit ndërton dhe rrit transparencën në punën e saj institucionale, nën garancinë e LDI-së. AKM do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së.

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit nëpërmjet pasqyimit të detajuar të tij në faqen zyrtare www.akm.gov.al si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin.

Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë.

Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e AKM – së është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj.

Skema e publikimit paraqitet nëpërmjet tabelës përmbledhëse të evidentuar në këtë program.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi Transparencës së AKM – së janë;

1. “E drejta për informim” është e drejtë Kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.

2. Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave: AKM-ja si (AP) ushtron funksione publike, për rrjedhje informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e AKM -së dhe përkatësisht: mbështetur në Ligjin “Për Mbrojtjen e Mjedisit” Nr. 10431 datë 09.06.2011, VKM-së Nr.47 datë 29.01.2014, “Për Përcaktimin e Rregullave për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të Agjencive Rajonale të Mjedisit”, VKM-së Nr.1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit”, Ligjit Nr.10448 datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, Ligjit Nr. 10881, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, VKM-së Nr. 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga Autoritetet Kompetente deri në lëshimin e këtyre nga QKL-ja”, Ligji Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, Regullore e miratuar nga Ministri i Mjedisit, vënë në dispozicion të AKM-së në datën 22.10.2014 “Për Organizimin dhe Veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare, Ligji Nr. 85/2012 datë 18.09.2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, Urdhër i Brendshëm i AKM- së Nr.114, datë 30.07.2014 “Për Kodin e Etikës”, Urdhër i Brendshëm i AKM-së me Nr. 134 Prot, datë 16.09.2014 “Për Disiplinimin e Marrdhënieve të Punës”, Urdhër i Brendshëm Nr. 115, datë 30.07.2014 “Për disiplinimin dhe efektivitetin në punë të punonjësve”, Formulari i Vlerësimit të Punës për Nëpunësit Civil të Kategorisë Ekzekutive, të Ulët dhe të Mesme Drejtuese bazuar në Ligjin Nr. 152/2013 “Për Nëpunësit civil”, etj.
4. Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.
5. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (këtej e tutje KDIMDP).
6. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.
7. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:
 - i plotë;
 - i saktë;
 - i përditësuar;
 - i thjeshtë në konsultim;
 - i kuptueshëm;
 - lehtësisht i aksesueshëm;
 - i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, Agjencia Kombëtare e Mjedisit vendos në dispozicion të publikut në faqen e saj të internetit www.akm.gov.al dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Strukturën organizative të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit
- Tekstet e plota, të konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, dokumente politikash, të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij dhe që prek publikun e gjerë;
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të AKM – së dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;
- Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi AKM, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;
- Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e liçencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e liçencuara;
- Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të konçesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për konçesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të AKM – së , duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura, shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara, informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;
- Informacion për shërbimet që AKM i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga AKM dhe të procedurave për t’i përfituar ato, informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh, çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga AKM;
- Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik, procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të AKM-së, një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor AKM-ja për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;
- AKM-ja, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë;

- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga AKM-ja.

Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme, përditësohet sa herë ai ndryshon.

IV. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË AGJENCISË KOMBËTARE TË MJEDISIT

Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë	Baza Ligjore Ligji 119 /2014 “ Për të Drejtën e Informimit”	Dokumenti/Përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Spektori Përgjegjës për përgatitjen e Materialit apo Disponimin e tij
Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik.	Neni7/1/a/d	Urdhër i Kryeministrit nr. 150, datë 17.04.2014 “Për një Ndryshim në Urdhërin Nr.55 “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit” VKM Nr. 47 datë 29.01.2014. “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe të Agjencive Rajonale të Mjedisit” Skemë e strukturës Struktura e pagave (Urdhëri i Kryeministrit përcakton kategoritë e	Pas botimit në fletoren zyrtare	www.akm.gov.al Menuja- “Baza Ligjore” www.akm.gov.al Menuja- “Drejtoritë e Agjencisë”	Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse Koordinatori i AKM-së për të drejtën e Informimit

		pagave të çdo nënpunësi) Tabelë e funksioneve, detyrave dhe kompetencave të Drejtorëve/ive, Arsimit, kualifikimet e drejtuesve			
Akte ndërkombëtare ligje; akte nën ligjore; dokument politikash; dokument tjetër.	Neni 7/1/b	Konventa Ndërkombëtare në fushën e mjedisit Ligje në fushën e mjedisit Akte nënligjore Manual ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të AKM dhe prek publikun e gjerë në fushën e mjedisit dhe Strategji Urdhër i Brendshëm i AKM- së Nr.114, datë 30.07.2014 “Për Kodin e Etikës”	Pas botimit në fletoren zyrtare Pas miratimit nga Ministri i Mjedisit Pas miratimit të urdhërit nga Drejtori i Përgjithshëm	www.akm.gov.al Menuja- “Baza Ligjore” www.akm.gov.al Menuja- “Ndikimi i Mjedisit”	Të gjitha Drejtoritë e AKM-së Koordinatori i AKM-së për të drejtën e Informimit
Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si	Neni 7/1/c/g	Format kërkesë Format ankese Shpjeguese Adresë postare Adresë e- mail www.akm.gov.al	Pas miratimit të Programit të transparencës Menjëherë në rast ndryshimesh	www.akm.gov.al Menuja- “E drejta për Informim”	Koordinatori i AKM-së për të drejtën e Informimit

dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.					
Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit.	Neni7/1/ç	<p>Adresa e AKM: Rruga “Sami Frashëri” Nr. 4, Tiranë</p> <p>Nga dita e hënë në ditë e enjte me orar 8⁰⁰-16³⁰ Ditën e premte me orar 8⁰⁰-14⁰⁰</p> <p>Gentian Rrodhe Koordinator për të drejtën e Informimit Agjencia Kombëtare e Mjedisit E-mail: gentian.rrodhe@akm.gov.al; koordinator@akm.gov.al info@akm.gov.al Cel: +3556790466 Fax: +355 4371242</p>	Pas miratimit të Urdhërit për caktimin e Koordinatorit	<p>www.akm.gov.al Menuja- “Home”</p> <p>www.akm.gov.al Menuja- “Koordinatori”</p>	Koordinatori i AKM-së për të drejtën e Informimit
Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve të cilët kanë detyrim për deklarim të pasurive, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë si dhe një përshkrim i procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve	Neni 7/1/d	<p>Në mbështetje të ligjit 9049 datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë i ndryshuar” janë përcaktuar kategoritë e nëpunësve që do dorëzojnë deklarimin e pasurisë.</p> <p>Për AKM për dorëzimin e deklaratës së pasurisë është Drejtori i Përgjithshëm i AKM dhe</p>	E përhershme	<p>www.akm.gov.al Menuja – “Deklarime të pasurisë”</p>	<p>Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse</p> <p>Koordinatori i AKM-së për të drejtën e Informimit</p>

të lartë të AKM, procedura që ndjekin për të marrë vendime.		Drejtorët e DRM-ve në Qarqe			
Mekanizmat monitorues; raporte auditit; dokumentet me tregues performance.	Neni 7/1/dh dh	<p>Raporte Monitorimi dhe auditimi (KLSH & MM)</p> <p>Raporte nga drejtoritë e AKM-së: Raporti Vjetor i Gjendjes në Mjedis Raporte të Vetmonitorimit të Subjekteve Harta me tregues mjedisor Informacione mbi TMD dhe PMM Raport për gjendjen e pyjeve dhe biodiversitetin</p> <p>Formulari i Vlerësimit të Punës për Nëpunësit Civil të Kategorisë Ekzekutive, të Ulët dhe të Mesme Drejtuese bazuar në Ligjin Nr. 152/2013 “Për Nëpunësit civil”</p>	<p>Menjëherë pas dorëzimit në AKM ose publikimit në faqen zyrtare të monitoruesve</p> <p>Pas miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm i AKM</p> <p>Mbështetur nga Drejtori i Përgjithshëm i AKM-së</p> <p>Menjëherë pas plotësimit të Formularit nga eprorët direkt të nëpunësve</p>	<p>www.akm.gov.al Menuja- “Informacione”</p> <p>Menuja- “Cilësia e Mjedisit”</p> <p>Menuja- “Statistika”</p> <p>Menuja- “Inovacione dhe TMD”</p> <p>Menuja- “Pyjet”</p> <p>Menuja- “Deklarata e pasurisë”</p>	<p>1-Drejtoria e Gjendjes dhe Cilësisë së Mjedisit 2- Drejtoria e Vlerësimit të Mjedisit 3- Drejtoria e Pyjeve 4- Drejtoria e Informacionit dhe Statistikave 5- Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve mbështetëse</p> <p>Koordinatori i AKM-së për të drejtën e Informimit</p>
Buxheti dhe plani i shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitin e kaluar, raporte	Neni 7/1/e	<p>Të dhëna për Buxhetin</p> <p>Plan i shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara</p>	Pas miratimit të Buxhetit nga MM, MF	www.akm.gov.al Menuja “Buxheti Vjetor”	<p>Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve mbështetëse</p> <p>Koordinatori i AKM-së</p>

vjetore për zbatimin e buxhetit.		Raporte vjetore për zbatimin e buxhetit			për të drejtën e Informimit
Informacion për procedurat e prokurimit sipas Ligjit 9643, datë 20.12.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.	Neni 7/1/ë	Lista e kontratave të lidhura nga AKM-ja Palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara Informacion për zbatimin e monitorimin e kontratave Udhëzues të APP-së për politika te ndryshme	Menjëherë pas miratimit nga titullari dhe të publikuara në Buletinin elektronik të APP-se	www.akm.gov.al Menuja “Buxheti vjetor” www.app.gov.al	Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve mbështetëse Drejtoria e Gjendjes dhe Cilësisë së Mjedisit Koordinatori i AKM-së për të drejtën e Informimit
Shërbimet e AKM për publikun.	Neni 7/1/f	Informacione për shërbimet qe AKM i jep publikut me standarte dhe cilësi në formë tabelare	Përditësohet në vazhdimësi	www.akm.gov.al Menuja “Informacione të tjera”	1-Drejtoria e Gjendjes dhe Cilësisë së Mjedisit 2- Drejtoria e Vlerësimit të Mjedisit 3- Drejtoria e Pyjeve 4- Drejtoria e Informacionit dhe Statistikave 5- Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve mbështetëse Koordinatori i AKM-së për të drejtën e Informimit
Paraqitja e	Neni 7/1/gj	p/akt ligjor dhe nën ligjor	Pas njoftimit	www.akm.gov.al	Të gjitha

mendimeve në hartimin e p/akteve, etj.		p/strategji në raund table, workshope të organizuar nga AKM dhe MM	zyrtar nga AKM dhe MM	gov.al Menuja “Të rejat e fundit”	Drejtoritë e AKM-së Koordinatori i AKM-së për të drejtën e Informimit
Mbajtja e dokumentacionit nga AKM.	Neni 7/1/h	Mbajtje në protokoll arshive të dokumentacionit në dy rregjistra: 1- Rregjistri i brendshëm 2- Rregjistri hyrës dhe dalës	Pas protokollimit të dokumentacionit	www.akm.gov.al	Protokoll-Arshiva e AKM-së Koordinatori i AKM-së për të drejtën e Informimit
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligjit Nr.119/2014.	Neni 7/1/i	Në formë tabelare (Lidha Nr 2)	Pas miratimit të Programit të Transparencës Çdo 3 muaj	www.akm.gov.al Menuja- “Programi i transparencës”	Të gjitha Drejtoritë e AKM-së Koordinatori i AKM-së për të drejtën e Informimit
Një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvensioneve të dhëna nga AKM dhe procedurave për t’i përfituar ato.	7/1/ j	Informacione në formë Tabelare	Pas miratimit të subvencioneve	www.akm.gov.al Menuja- “Informacione”	Drejtoria e Informacionit dhe Statistikave Koordinatori i AKM-së për të drejtën e Informimit
Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh.	Neni 7/1/k	Informacione për <ul style="list-style-type: none"> • Lejet e mjedist • VNM 	Pas Miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm	www.akm.gov.al Menuja- “Mbrojtja e të	Të Gjitha Drejtoritë e AKM-së

		<ul style="list-style-type: none"> • Gjendjen e treguesve mjedisorë • Kodin unik të mbetjeve • Të dhëna statistikore për nëpunësit e AKM-së si persona të larguar, vende vakante, vlerësimi i punonjësve, etj 		<i>dhënave”</i>	Koordinatori i AKM-së për të drejtën e Informimit
Informacione të tjera të dobishme.	Neni 7/1/1	Informacion shtesë (evente, workshope trajnime, etj) për funksionimin e AKM-së	Pas miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm	www.akm.gov.al Menuja- “Të rejat e fundit”	Të gjitha Drejtoritë e AKM-së Çdo nëpunës i AKM-së Koordinatori i AKM-së për të drejtën e Informimit

V. PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, AKM vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit www.akm.gov.al dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mësipërme, në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës”.

VI. MONITORIMI

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit. Komisioneri bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës.

MIRATOI:

Julian BEQHRI
Drejtori i Përgjithshëm i AKM



II. PARIMI TË PËRGJITHSHËMË

Parimi i përgjithshëm në zbatimin e Programit Transparencës të AKM – së bashku me Ligjin për informimin dhe drejtë Kushtetuese e parashikuar në artin 23 të saj, e cila mundësi nga të gjithë pa e një përparim.